



## THIRRJE PUBLIKE

### IP Shtëpia e Kulturës "Koço Racin"-Shkup shpall Thirrje publike për financimin e projekteve dhe aktivitetete nga lëmia e artit vizuel

Të gjithë të interesuarit mund të dorëzojnë propozime për mbështetjen e projekteve profesionale, amatore dhe të rinjve, manifestime dhe aktivitete nga lëmi të ndryshme, siç janë: arte vizuale, dizajn dhe arkitekturë dhe art i mediave të reja. Të interesuarit mund të aplikojnë edhe për realizimin e ekspozitave personale të pikturave, skulpturave, grafika, vizatime, fotografi, qeramikë, dizajn mode, dizajn enterieri dhe të tjera. Propozimet mund të dorëzohen edhe për realizimin e ekspozitave në grup të artistëve, studentë të artit, ekspozita nga koloni artistike, ekspozita të cilat përfshijnë prezentime të dorëshkrimeve, por edhe ekspozita të cilat përfshijnë përdorimin e teknikave dixhitale moderne, instalimeve, shfaqjeve multimediale dhe formave të tjera me temë sipas zgjedhjes. Kjo Thirrje Publike mundëson financimin e një numri të caktuar projektsh, tërësisht ose pjesërisht, bashkëpunim lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, profesional amator dhe për të rinjtë. Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë artistët, artistë të pavarur, institucione kulturore, shoqata të qytetarëve, fondacione dhe persona të tjerë juridikë e fizikë që kryejnë veprimtari kulturore në përputhje me Ligjin për Kulturë dhe rregulloret e tjera pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë. Përveç lëmimeve specifike të shënuara, aplikacionet e dorëzuara duhet të përmbushin objektivat dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve në fushën e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit, të cilat i bashkëngjiten Thirrjes Publike të publikuar në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk).

Aplikacionet mund të merren në IP Shtëpia e Kulturës "Koço Racin" –Shkup ose në faqen zyrtare të IP Shtëpia e kulturës "Koço Racin"- Shkup <http://www.dk-kocoracin.org.mk/>

Thirrja publike do të zgjas 10 dit duke filluar nga 07.02.2019

Informacione shtes mund të merren nga numrat e telefonit në vijim: 02/ 3163- 739, 071/ 232- 706, 077/ 19 302, dhe adresën e e-mail:

[dk.kocoracin@gmail.com](mailto:dk.kocoracin@gmail.com)

[violetaelizabeta@gmail.com](mailto:violetaelizabeta@gmail.com)

Me respekt,

Drejtor

Safet Kamberi

